



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.724/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit I. M., për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3336/2022, të datës 14.08.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1203/2023, të datës 24.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit I. M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3336/2022, të datës 14.08.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1203/23, të datës 24.09.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3336/2022, të datës 14.08.2024, i dënuari I. M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe veprës penale kanosje nga neni 181 paragrafi 3 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për veprën penale nën I të dispozitivit të aktgjykimit gjykata i ka shqiptuar dënimin me burgim në

kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muajve, ndërsa për veprën penale nën II të dispozitivit të aktgjykimit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve. Në pajtim me nenin 76 të KPRK-së, gjykata të dënuarin e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 10 (dhjetë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. Koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak nga data 05.12.2022 e deri më datë 14.06.2023 i llogaritet në dënimin e shqiptuar në rast të revokimit. I dënuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20 €.

Pala e dëmtuar E. E. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil, ndërsa i dëmtuari S. S. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1203/2023, të datës 24.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari I. M., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ndërsa të ndryshohen aktgjykimet e lartcekura, ashtu që të dënuarin ta liroj nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.411/2023, të datës 25.11.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoj se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

I dënuari, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka formuluar dispozitivin e aktgjykimit dhe jashtë asaj çka është theksuar në aktin akuzues si dhe precizimin e këtij akti. Pretendohet se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit janë në kundërtënie të plotë njëri me tjetrin me çka është krijuar konfuzitet, pakjartësi, difuzitet i plotë në pjesët kryesore të aktgjykimit. Aktgjykimi i shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe kundërtënes. Më tutje në kërkesë thekson se gjykata e shkallës së parë do të duhej që në aktgjykim të përfshijë elementet esenciale të veprës penale si dhe kryesit eventual të saj,

rrethanat objektive koha dhe vendi i kryerjes si dhe mënyrën e kryerjes duke u thirrur në dispozitat konkrete si dhe elementet subjektive të kryesit eventual të veprës e që janë përgjegjësia penale eventuale, dashja për të kryer ose pakujdesia si dhe sidomos elementin e kauzalitetit ose lidhshmëria e kryerjes së veprës penale në mes veprimit të kryerësit si dhe shkaktimit të pasojës.

Në një pjesë të kërkesës i dënuari thirret edhe në gjendjen faktike të vërtetuar e në të cilën gjendje faktike përshkruhen edhe procedurat kontestimore të cilat i ka zhvilluar i dënuari si palë paditëse në gjykata.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal.

Aktgjykimet e dy gjykatave si tërësi, por edhe arsyetimet e tyre janë të qarta, të kuptueshëm dhe nuk përmbajnë kundërthënie me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Përshkrimet e dhëna në arsyetimin e aktgjykimeve përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë është i kuptueshëm i qartë dhe konkret si dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin, përpilimi i të cilave është bërë konform dispozitave të nenit 369 paragrafi 4 të KPP-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprave penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor.

Po ashtu në arsyetimin e aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale duke u bazuar në dispozitat e nenit 369 paragrafi 6 të KPP-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si ato faktike ashtu edhe ato juridike.

Aktgjykimet e kundërshtuara me kërkesë janë bazuar në prova të ligjshme dhe të pranueshme të cilat si të tilla janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve-E. E., S. S., mbrojtja e të dënuarit, video incizimi nga vendi i ngjarjes. Gjykata ka bërë vlerësimin e provave konform nenit 360 paragrafi 1 të KPP-së me që rast ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale nga ana e të dënuarit I. M..

Gjykata drejtë ka vërtetuar se nuk ishte kontestuese që i dënuari I. M., ditën kritike me datën 05.12.2022, kishte shkuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan dhe kishte takuar të dëmtuarit E. E. dhe dhe S. H.,-gjiqtar të kësaj gjykate dhe kishte ndërmarr veprimet si ndaj njërit të dëmtuar dhe tjetrit ashtu siç janë të përshkruar në dispozitivin nën I dhe II të

aktgjykimit, sipas dispozotivit nën I, pasi që ishte ftuar për seancë tek e dëmtuara E. E. dhe e njëjta e kishte njoftuar se seanca nuk do të mbahej sepse nuk ishin plotësuar kushtet ligjore, përkundër faktit që ishte njoftuar nga e dëmtuara –gjyqtarja që nuk kishte kushte ligjore për mbajtjen e seancës, ai me dashje me forcë dhe me kanosje serioze-gjyqtarën ka penguar atë në kryerjen e detyrave zyrtare, dhe sipas dispozotivit nën II të aktgjykimit në datën e njëjtë si në dispozitivin nën I, me dashje e kanos personin zyrtar –gjyqtarin S. H., ku i dënuari ndaj të dëmtuarit shfaq shenja të agresivitetit, kishte ngritur dorën dhe i drejtohet me gisht të dëmtuarit dhe gjatë komunikimit me të dëmtuarin ai e kishte kanosur atë me fjalë apo gjeste se do ti ndodhë ndonjë e keqe.

Gjithashtu, duke u bazuar në përmbajtjen e kërkesës, pretendimet kanë të bëjnë edhe me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate duke u bazuar në dispozitën e nenit 432 paragrafi 2 të KPP-së-, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mundë të ushtrohet mbi këtë bazë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se, aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira as me shkelje të ligjit penal, siç pretendon i dënuari pa të drejtë, për faktin se në veprimet e të dënuarit përfshihen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale pengimi i personit zyrtar kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe të veprës penale kanosje nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.724/2024, më datë 12.12.2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi